



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.107/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada- Gllgjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Dardanë për shkak të mbulimit të posterit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Dardanë i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4,500.00 (*katërmijë e pesëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017 në rrugën “Isa Kastrati”, përballë shtëpisë së kulturës në Dardanë, aktivisti tyre ka vërejtur se është mbuluar posteri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizje Vetëvendosje me posterin e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Koalicioni PDK-AAK-NISMA.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni PDK-AAK-NISMA, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika a e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse mbulimi apo dëmtimi i materialit tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Lidhur me këtë ankesë parashtruesi i saj ka bashkangjitur fotografi si provë për shkeljen e pretenduar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA thekson se në momentin e pranimi të Urdhërit për Përmirësim nga ana e PZAP-it, kanë ndërmarrë masa për evitimin e shkeljes.

Ndërsa nga përgjigja në ankesë e subjektit politik AAK si pjesë e këtij koalicioni, theksojnë se vendosja e posterave të kandidatit të tyre mbi posterat e kandidatit të subjektit politik LVV-së nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së, mirëpo i njejt mund të jetë vendosur nga individ të pa identifikuar dhe se në momentin që kanë pranuar Urdhërin për Përmirësim kanë njoftuar strukturat menagjuese të fushatës për të bërë heqjen e posterave të tyre.

Lidhur me veprimet e ndërmarra përgjigjes në ankesë iu ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA i kanë mbuluar posterat e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika a) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon heqjen, mbulimin dëmtimin ose ndryshimin e ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika a), të LZP-së, pasi që posterat e kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA janë vendosur mbi posterat e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion janë vendosur mbi posterat e subjektit politik LVV. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se, brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterat në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.107/2017 më datën 07.06.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.